

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr. akti 460

Korce, me: 26.03.2019

S H K R E S E- percjellese

Bashkise Maliq

Lutemi vendoseni njerën nga kopjet e shpalljes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce dt.26.03.2019 për njoftimin e të paditurës Aleksa Dhimitri per nxjerjen e urdherit per caktimin e séances gjyqesore, që po u dergojme në vendin tuaj të afishimit, e tjetren dergojeni perseri në adresë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce me konfirmimin e afishimit të shpalljes.



- Aktesh
- 2 Supozicionet Publike
01.04.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr. akti 460

Korce, me: 26.03.2019

Shpallje

“Per njoftimin e urdherit per caktimin e seances gjyqesore”

Ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korce, po gjykohet çështja civile me nr. Regj. Them. 460 me pale ndergjyqese:

Padites: Endri Kociu

E paditur: Aleksa Dhimitri

Objekti: Zgjidhje martesë etj

Baza ligjore: Neni 132 e vijues i Kodit të Familjes

Gjyketes i rezulton se e paditura Aleksa Dhimitri, me adrese të vendbanimit zyrtar në Maliq, Blloku nr.2 si dhe me adrese të vendbanimit faktik në Erseke, nuk ndodhet në banesë, por është larguar jashtë shtetit.

Fakti i mesipërme i qenies së saj jashtë shtetit është konfirmuar nga të dhënat e sistemit TIMS për të.

Në këto kushte e në mbështetje të nenit 133/a, pika(b) e 133/b të Kodit të Procedurës Civile, gjykata ka vendosur njoftimin e të paditues të mesipërme me shpallje publike me afat 20 ditë, duke shpallur (afishuar) atë në ambientet e dukshme të gjyketes; në Bashkinë Maliq, në territorin e së cilit ajo ka pasur vendbanimin e fundit zyrtar për largimit jashtë shtetit; në Bashkinë Kolonjë, në territorin e së cilit ajo ka pasur vendbanimin e fundit faktik të ditur për largimit jashtë shtetit; në vendin ku ajo ka pasur vendbanimin e fundit zyrtar për largimit jashtë shtetit, pra në Maliq, Blloku nr.2 (derën e shtëpise), në vendin ku ajo ka pasur vendbanimin e fundit faktik të ditur për largimit jashtë shtetit, pra në Erseke (derën e shtëpise) si dhe do të botohet në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjyketes.

Në seancën përgatitore të datës 20.02.2019, në kushtet kur nuk u realizua pajtimi e u përcaktua natyra e mosmarrëveshjes e provat që do të paraqiten, gjykata në mbështetje të nenit 134, 135 të Kodit të Familjes e nenit 158/c të Kodit të Procedurës Civile, nxorri urdherin për caktimin e séances gjyqësore, me përmbajtje si më poshtë:

1. Caktimin e séances gjyqësore.
2. Në séance gjyqësore, do të paraqiten si prova nga paditesi:


- Certifikate martesë
 - Certifikate familjare
 - 3 certifikata personale për paletë e për femijën e tyre
 - Vertetim i bashkisë Maliq nr.839 prot, datë 30.05.2018.(Një pjesë e ketyre provave ndodhen në dosjen gjyqësore civile që i përket vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce nr.864, datë 17.07.2018- dosja e pushuar).
3. Kryerjen e relacionit të vlerësimit psikologjik nga psikologjia Marinela Postoli.

Në kushtet kur seanca përgatitore dt.20.02.2019, është zhvilluar në mungesë të të paditurës Aleksa Dhimitri, gjykata në mbështetje të nenit 158/c/1 i Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur njoftimin e urdherit të caktimit të seances gjyqësore të paditurës në mungesë. Në rrethanat kur e paditura ka qenë jashtë shtetit e njoftimi i saj për gjykim është bërë me shpallje, edhe njoftimi i urdherit për caktimin e seances gjyqësore do të bëhet perseri me shpallje, afishuar për 20 ditë në vendet e mesipërme.

Me afishimin e kësaj shpallje vihet në dijeni e paditura Aleksa Dhimitri, për nxjerrjen e urdherit të gjykatës dt.20.02.2019 për caktimin e seances gjyqësore e për përmbajtjen e tij.

Kjo shpallje zëvendëson njoftimin(komunikimin) e rregullt për të paditurën Aleksa Dhimitri në lidhje me urdherin e gjykatës dt.20.02.2019 për caktimin e seances gjyqësore e për përmbajtjen e tij.

GJYQTARE
Ariola Kristo



U afishua në Bashkinë Maliq në dt _____.
Për Bashkinë Maliq _____.
(emer, mbiemer, firmë)